



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VAU DEJES

**NJOFTIM**

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; të Ligjit nr 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; VKM nr Nr. 768, datë 15.12.2021, “Për përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, llojeve të shërbimeve të veçanta, për të cilat mund të rezervohet e drejta e pjesëmarrjes së organizatave në procedurat e prokurimit publik, si dhe rregullave të detajuara për prokurimin e tyre”; VKB nr.74, datë 23.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës”, ***Bashkia Vau Dejës njofton të interesuarit/konkurrentet se kërkon të organizojë një event në datën 16.08.2026, ora 20:00, duke u bazuar në kriteret e mëposhtme.***

**KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

**KRITERET E VEÇANTA**

1. Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të jetë jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me

vulë elektronike. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2. Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2026(Sipas kesteve te maturuara) duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin.
3. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më pak se 20% të fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë;

a) Kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara ose vërtetimin për realizimin me sukses të kontratës shoqëruar me faturat tatimore të shitjes, ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.

b) Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.

Nr	FESTA E 16 GUSHTIT	Specifikimet
1	Koncert festiv me pjesemarrje te kengetareve te njohur (2 kengetareve te njohur kombëtar)	Koncert festiv me pjesemarrje te kengetareve te njohur kombetar . Ne total duhet te mbulohet se paku 150 minuta spektakel. i perfshire prezantuesi.
2	Koncert festiv me pjesemarrje te kengetareve te njohur (3 kengetareve te njohur lokal)	Koncert festiv me pjesemarrje te kengetareve te njohur kombetar . Ne total duhet te mbulohet se paku 150 minuta spektakel. i perfshire prezantuesi.
3	FV skene per rastin (6X6x0,7 m)	F.V. skene outdoor per rastin (6X6x0,7 m). Skena mund te jene ne pronesi apo te marra me qera nga OE per aktivitetin perkates me nje siperfaqe totale jo me pak se 36 m2, me gjatesi 6mX6m dhe lartesi 0.7 m.
4	Foni	Aparatura qendër zëri rreth 4000w për të përmbushur akustikën e kërkuar, si dhe mbushur të gjithë sheshin me volum, të jetë i pranueshëm në audiencë si dhe per te arritur atë që kërkojnë

		artistët. Fonia është termi i përgjithshëm i sistemit audio dhe aty përfshihen të gjitha setet e nevojshëm si artopolante(bokse) speaker, monitor, mikrofona, pult fuqie, pult mikser, kamaleca mikrofonash dhe boksesh, stabilizator dhe kabul për mikrofonat dhe lidhje e bokseve me aparatura mikser dhe fuqie, lap-top, etj
5	Ndricimi i skenes dhe ndricim i ambientit rrethues ku do te zhvillohet aktiviteti ( Fusha Sportive Bushat)	Ndricimi i skenes (Prozhektor, Robot, Tymese)

- **Eventi organizohet me datë 16.08.2026, ora 20:00**
- **Kërkesat për pjesmarrje do të paraqiten, pranë sekretarisë së Bashkisë Vau Dejës me zarfe të mbyllura, me shënimin të mos hapet përpara datës 22.06.2026, ora 09:00.**
- **Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave për pjesmarrje është data 22.06.2026, ora 09:00, në çdo rast subjektet e interesuar mund të bëjnë kërkesë për informacion apo sqarime në rrugë elektronike në adresën [dorina.lini@vaudejes.gov.al](mailto:dorina.lini@vaudejes.gov.al)**